



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KODI ETIKËS

Datë 31.05.2018

Ky kod është hartuar

Mbështetur në nenin 5, nenin 20, nenin 32,dhe nenin 51 të ligjit nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe objekti

1. Ky kod ka për qëllim të vendos rregullat e sjelljes së personelit të Strukturës Mbështetëse të BMP-së dhe anëtarëve të komisioneve të ngritura pranë BMP-së në përputhje me ligjin si dhe statutin dhe kuadrin rregullator të BMP-së si dhe anëtarëve të cilët janë në strukturat drejtuese të të gjitha organizatave profesionale subjekt i mbikëqyrjes së BMP-se, sipas standardeve të kërkuara, t'i ndihmoje ata për arritjen e këtyre standardeve dhe të vendos në dijeni publikun për sjelljen që duhet të kenë personat e angazhuar në rolet e mësipërme.
2. Ky Kod ka për qëllim përcaktimin e standardeve etike mbi të cilat duhet të funksionojë Bordi i Mbikëqyrjes Publike së bashku me SM dhe komisionet e ngritura pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
3. Gjithashtu, në këtë Kod, përcaktohen vlerat themelore dhe parimet e punës së të gjitha subjekteve që duhet të jenë në pajtueshmëri me këtë kod duke përcaktuar themelet për përgjegjshmërinë etike .

Neni 2 Shkurtime dhe Përkufizime

1. Shkurtime e përdorura në këtë kod kanë këto kuptime:

BMP- Bordi i Mbikëqyrjes Publike

SM – Struktura Mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike

Komisione – Të gjitha komisionet dhe komitetet dhe grupet e punës të ngritura pranë BMP-së

Ligji për auditimin: Ligji nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, i ndryshuar.

2. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përdorura në nenin 2 të ligjit për auditimin.
3. Termat ose shkurtime më sipër mund të përdoren si zëvendësues të njëra tjetrës.

Neni 3 Fusha e veprimit

1. Dispozitat e këtij kodi janë te detyrueshme për SM të BMP-së dhe anëtarët e komisioneve të ngritura pranë BMP-së për sa kohe nuk parashikohet ndryshe në dispozita të tjera ligjore.

Neni 4 Vlerat Themelore dhe Parimet e Punës

1. Vlerat themelore mbi të cilat duhet të mbështeten personat subjekt të këtij kodi janë sa më poshtë:
 - **Integriteti:** Objektivat duhet të arrihen nëpërmjet ndershmërisë dhe seriozitetit duke respektuar rregullat dhe etikën profesionale.
 - **Drejtësia:** Në punë dhe në parimet e tyre, të gjitha subjektet e kodit duhet të udhëhiqen nga ajo që është e drejtë dhe e ndershme.

- **Interesi publik i pari:** Të gjitha subjektet e këtij kodi në punën e tyre duhet të kenë në konsideratë interesin e publikut.
- **Transparenca:** Të gjitha subjektet e këtij kodi duhet të udhëhiqen nga vlerat e transparencës dhe besueshmërisë.
- **Përgjegjshmëria:** Subjektet e këtij Kodi duhet të veprojnë me përgjegjshmëri të lartë ndaj të gjithë palëve në pajtueshmëri me kuadrin rregullator.

2. Parimet e punës duhet të mbështeten në :

Përgjegjësi : Detyrat duhet të kryhen në bazë të rregullave dhe etikës profesionale

Komunikim i hapur: Subjektet e këtij kodi duhet të mbështeten në një komunikimin e hapur me qëllim që të gjithë të ndihen të përfshirë.

Cilësi : Të gjitha subjektet e këtij kodi duhet të kenë fokusin te cilësia

Efikasiteti: Puna nga të gjithë personat që janë të përfshirë në aktivitetet e subjekteve të këtij kodi duhet të veprojnë me efikasitet.

Neni 5

Parime të përgjithshme të etikës

1. Ne kryerjen e funksioneve, personi i angazhuar në funksionet të cilat janë subjekt i këtij kodi duhet të respektojë parimet si më poshtë:
 - a) të kryejë detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - b) të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike e të mos pengojë zbatimin e kuadrit rregullator dhe të vendimeve ose veprimeve ligjore të Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
 - c) të kryejë detyrat me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;
 - d) të jetë i sjellshëm në marrëdhënie me qytetarët që u shërben, dhe me eprorët, kolegët e vartësit e tij;
 - e) nuk duhet të veproje arbitrarisht në dëm të një personi ose organizate dhe duhet të tregojë respektin e duhur, për të drejtat dhe interesat personale të të tretëve;
 - f) të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij në shërbim të interesit publik, të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat;
 - g) të sillet gjithnjë në mënyrë të tillë, që besimi i publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik, të ruhet e të rritet;
 - h) të ruajë konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi.
 - i) Të mos dëmtoj imazhin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike në çfarëdolloj forme .
 - j) Të mos keqpërdorë informacionin duke dëmtuar imazhin e profesionit.
3. BMP mund të nxjerrë rregulla në zbatim të parimeve të treguara në pikën 1 të këtij neni.

4. Në rastet kur profesionisti kontabël përballet me rrethana jo të zakonshme, në të cilat profesionisti kontabël apo subjekti i mbikëqyrjes beson se rezultati i zbatimit të një kërkesë specifike të këtij kodi mund të mos i shërbej interesit publik atëherë ai inkurajohet të konsultohet ose ti drejtohet Bordit të Mbikëqyrjes Publike për një interpretim në zbatimin e këtyre kërkesave.

Neni 6

Konflikti i Interesave

1. Konflikti i interesave është situata në të cilën një anëtar i komisioneve të ngritura pranë BMP-së apo komisioneve dhe komiteteve apo strukturave drejtuese të organizatave profesionale ka një interes personal të tillë, që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës. Interesat personale të personave të sipërcituar përfshijnë çdo përfitim për veten, apo familjen nga përdorimi i funksionit.
2. Në rastet kur kemi të bëjmë me një situatë, e cila kërkon një vendimarrje që rezulton me përfitim sikurse është parashikuar në pikën një të këtij neni, personi mund të heqë dore përkohësisht ose t'i transferojë këto interesa për të gjitha rastet që sjellin një përfitim/përparësi ndaj tij, në mënyrë të tillë që mundësia e konfliktit të interesave si rrjedhojë e kësaj vendimarrje të shmanget.

Neni 7

Përfitimi

1. Personat e angazhuar në funksionet e parashikuara në nenin 1 nuk duhet të kërkojnë ose të pranojnë, dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitim tjetër, ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen nga personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie (të cilat mund të sjellin përfitime si rrjedhojë e ushtrimit të funksionit), që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës së përcaktuar në këtë në funksionet të cilat janë subjekt i këtij kodi.
2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e ftesave të zakonshme, të mikpritjes tradicionale, të dhuratave me vlerë simbolike ose tradicionale të mirësjelljes, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi paanshmërinë e personave subjekt i këtij kodi.
3. Në rast dyshimi mbi paanshmërinë e përfitimeve, personat më sipër këshillohen me Kryetarin e BMP-së.

Neni 8

Reagimi ndaj ofertave

1. Në qoftë se personave subjekt të këtij kodi i ofrohet një avantazh i padrejtë, ai duhet:
 - a) ta refuzojë, pa pasur nevojë ta pranojë atë për ta përdorur si provë;
 - b) të përpiqet që ta identifikojë personin që i bën ofertën;

- c) te shmange kontaktet e gjata me personin qe beri ofertën, por dijenia e arsyes për te cilën behet oferta, mund te shërbejë si prove;
- d) ne qofte se dhurata nuk mund te refuzohet qe t'i kthehet dërguesit, duhet te ruhet, te përdoret sa me pak qe te jete e mundur dhe t'i raportohet menjëherë eprorit direkt;
- e) te ketë dëshmitarë, nëse është e mundur, koleget qe punojnë me te;
- f) te raportoje përpjekjen, sa me shpejt qe te jete e mundur, tek eprori i tij ose te Kryetari i BMP-së;
- g) te vazhdoje punën normalisht, sidomos për problemin për te cilin avantazhi i padrejte është ofruar.

Neni 9

Detyrimet e personave të angazhuar të cilët janë subjekt i këtij kodi

Personi i angazhuar i cili është subjekt i këtij kodi nuk duhet ta përdorë ose te lejoje ta përdori detyrën zyrtare te tij, ne mënyrë te tille qe te nxisë ose te detyroje ndonjë person tjetër, përfshirë edhe vartësit, për te pasur ndonjë përfitim financiar ose te çdo lloji tjetër me interes personal.

Neni 10

Dispozita zbatuese

1. SM është e detyruar t'i beje te ditur personit të angazhuar në funksionet subjekt të këtij kodi detyrimet qe rrjedhin nga ky ligj dhe qe duhen respektuar nga nëpunësi.
2. Personat e angazhuar në funksionet të cilat janë subjekt i këtij kodi duhet te kërkojnë këshillim nga personeli juridik i BMP-së ose Kryetari i BMP kur është i pasigurt për te vepruar.
3. Dispozitat e këtij kodi janë pjese e kushteve te angazhimit të personave subjekt të këtij kodi.

Neni 11

Masat Disiplinore

Personat e angazhuar në funksionet që janë subjekt i këtij kodi që shkelin parimet e etikës, të përcaktuara në këtë kod, kur veprimet e tyre nuk përbejnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kuadrin rregullator të zbatueshëm.

Hyrja në fuqi

Ky kod hyn menjëherë në fuqi.

KRYETAR

DRITAN FINO

